



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE
AGJENCIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE

Nr. 925/Prot.

Tiranë, më 03.07.2024

Lënda: Përgjigje ftesës për bashkëpunim, shkresa Nr. 2577 Prot., datë 28.06.2024

ZOTI FATMIR XHAFAJ
KRYETAR
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

I nderuar z. Xhafaj,

Jemi njohur me shkresën për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian” dhe rolin e tij të rëndësishëm që do të ketë në proceset reformuese të Shqipërisë 2030.

Duke ju falenderuar për dërgimin e ftesës për bashkëpunim dhe t’ju uroj suksese në punën tuaj në drejtimin e këtij komisioni, shprehim angazhimin serioz të Agjencisë së Inteligjencës Financiare për të kontribuar në punën e këtij komisioni në funksion të thellimit të reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian.

AIF gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të veta, ka rol indirekt në secilën nga fushat e cituara në shkresë. Për këtë arsye kemi vlerësuar që të raportojmë në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

- Detyrat dhe funksionet e Agjencisë së Inteligjencës Financiare (AIF);
- Sistemin parandalues në vend;
- Natyra e rasteve që shpërndajmë;
- Kthim përgjigjet për kërkesat për informacion që i drejtohen AIF;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar;
- Vlerësimi Kombëtar i Riskut të PP/FT;
- Ndryshimet ligjore;
- Procesi i monitorimit të Shqipërisë nga FATF/ICRG;

- Propozime për ndryshime ligjore;
- Puna në proces për hartimin e Strategjisë Kombëtare kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

I. Detyrat dhe funksionet kryesore të AIF

Mbështetur në parashikimet e Ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" i ndryshuar, neni 21 dhe 22, AIF:

- mbledh, administron, përpunon, analizon dhe shpërndan tek autoritetet kompetente të dhëna, raporte dhe informacione për çështjet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- shkëmben informacion me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Policinë e Shtetit dhe autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës, për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale, veprat penale ose veprimtaritë kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale, financimit të terrorizmit.

Organet në të cilat AIF dërgon raste për investigim të mëtejshëm janë kryesisht Policia e Shtetit por edhe Prokuroritë, bazuar në tipologjinë e rastit, kompetencën e organit pritës, lidhjen me hetime të mëparshme, nëse janë nxjerrë urdhra bllokimi etj.

Në funksion të detyrës funksionale kryesore si më sipër, AIF siguron, pranë subjekteve të ligjit apo organe publike, të dhënat që çmon të nevojshme sipas veçorive të rasteve në trajtim, i analizon ato dhe konkludon me secilin rast në shqyrtim.

Statistikat për rastet e dërguara në organet ligj zbatuese për periudhën 2019 – 6 mujori I 2024 janë si vijon:

Viti	2019	2020	2021	2022	2023	6-Muj. I 2024
Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm	25 ¹	27	21	13	19	17
Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	-	14	29	10	26	11
DPPSH	241	227	208	201	175	67
Total	266	268	258	224	220	95

Përveç rasteve të mësipërme, AIF dërgon edhe një sërë informacionesh vijuese, rreth 80-100 në vit, të lidhura me raste të dërguara me herët, apo për të cilat ka pasur korrespondenca të mëparshme në kuadër të kthim përgjigjeve.

Në rastet kur AIF ka arsye të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete për PP/FT, në funksion të parandalimit të tjetërsimit të produkteve financiare kriminale, urdhëron bllokimin ose ngrirjen e përkohshme të transaksionit ose të veprimit financiar, për një periudhë jo më shumë se 72 orë

¹ Nga këto 2 janë dërguar në Prokurorinë për Krime të Rënda.

dhe informon Prokurorinë kompetente dhe sipas rastit, nëse është e nevojshme, organe të tjera të zbatimit të ligjit. Urdhrat e bllokimit dhe sekuestrimet (në EUR) për periudhën 2019 – 6 muhori I 2024.

Viti	Nr. i urdhrave të bllokimit nga AIF	Pasuria totale e bllokuar (EUR)	Pasuria totale e sekuestruar (EUR)	Raporti sekuestrime/ bllokime
2019	16	9,699,690	7,841,091	81%
2020	7	1,172,291	1,172,886	100%
2021	3	250,240	200,000	80%
2022	3	2,426,882	2,426,882	100%
2023	4	1,178,350	1,100,350	93%
6 - Muj. I 2024	9	10,543,335	10,189,889	95%

AIF publikon çdo vit në faqen e saj zyrtare² raportin vjetor në të cilën paraqiten aspekte kryesore të punës së saj duke përfshirë këtu jo vetëm statistika por edhe përshkrim të treguesve me anomali, indicie, mënyrës së veprimit dhe metodave të ndjekura për kryerjen e PP/FT dhe tipologji të rasteve të trajtuara. Bashkëlidhur kësaj shkrese ju dërgojmë edhe një kopje të fundit të raportit vjetor 2023.

II. Sistemi parandalues

Qëllimi i legjislacionit³ mbi të cilin orientohet kryesisht puna e AIF është *“Të parandalojë pastrimin e parave dhe të produkteve që burojnë nga veprat penale, si dhe parandalimin e financimit të terrorizmit.”*

Në mënyrë të përmbledhur, parandalimi funksionon sipas kolonave të mëposhtme:

- parashikim detyrimesh për subjektet raportuese (banka, noter, shoqëri transfertash, zyra këmbimi valutore etj), të cilat mund të grupohen në regjistrim dhe ruajtje të dhënash/dokumentacioni, vlerësim risku për klientët, ushtrim vigjilence sipas rastit/transaksionit apo llojit të klientit (vigjilencë e duhur apo zgjeruar), trajnime për stafin, detektim dhe raportim në AIF për raste të aktivitetit të dyshimtë (RAD), raportim në AIF për transaksione mbi pragun ligjor si dhe kthim përgjigje për kërkesat e dërguara nga AIF;
- ushtrimi funksioneve nga ana e autoriteteve mbikëqyrëse⁴, të cilat kanë për detyrë që të mbikëqyrin nëpërmjet inspektimeve, përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve me detyrimet e parashikuara në këtë ligj.

² <https://fiu.gov.al>

³ Ligj Nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore përkatëse

⁴ Neni 24 i ligjit të sipërcituar, në mënyrë të përmbledhur

➢ Banka e Shqipërisë për: a) subjektet bankare; b) subjektet financiare jobanka; c) zyrat e këmbimeve valutore; ç) shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre; d) shërbimet postare që kryejnë shërbime pagesash;

➢ Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për: a) bursat dhe çdo subjekt tjetër (agjent, broker, shoqëri komisionere etj.), që ushtron veprimtari për emetimin, këshillimin, ndërmjetësimin, financimin dhe çdo shërbim tjetër që ka lidhje me tregtimin e titujve; b) shoqëritë që merren me sigurimin e jetës ose ri sigurimin, agjentët apo ndërmjetësit e tyre, si dhe fondet e pensionit; c) shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe të fondeve të pensioneve, si dhe agjentët e tyre;

Thelbi i funksionimit të sistemit parandalues është dërgimi i RAD nga ana e subjekteve të ligjit apo institucioneve publike që kanë detyrime. Kështu, për periudhën 2019-2023, të dhënat statistikore për RAD e marra nga AIF paraqiten si më poshtë vijon:

Subjekti raportues	2019	2020	2021	2022	2023
Banka	651	703	725	660	756
Shoqëri transfertash	319	315	290	293	323
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	43	44	33	25	24
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	12	10	6	9	8
Agjencia Shtetërorë e Kadastrës	33	-	16	22	29
Noter	335	321	482	735	516
Zyra të këmbimit valutor	6	4	4	9	32
Inst. financiare të mikro-kredisë	-	9	17	28	21
Shoqëri të qiradhënies financiare	-	-	1	-	5
Shoqëri ndërtimi	5	2	2	-	1
Shoqëri tregtimi mjeteve motorike	10	-	-	3	3
Shoqëri pagesash elektronike	-	-	3	6	8
Tjetër	10	1	2	-	2
Total	1,424	1,409	1,581	1,790	1,728

Pjesë e rëndësishme e sistemit parandalues është dhe ushtrimi nga AIF i procesit të mbikëqyrjes⁵ së përputhshmërisë së subjekteve të ligjit nr.9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar. Në këtë kontekst AIF realizon inspektime në vend apo në distancë të subjekteve të ligjit si dhe trajnime për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Të dhënat për inspektimet dhe trajnimet e realizuara paraqiten në tabelat në vijim.

Inspektimet në vend dhe në distancë për periudhën 2019 – 2023.

Nr.	Subjektet	2019		2020		2021		2022		2023	
		Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë
1	Banka	5		2		5		3		4	
2	IFJB	3	9	2	5	7	5	1	1	6	1
3	ZKV	16	25	4	38	4	20	7	10	4	16
4	Ekspertë kontabël	10	3	2	8				5	2	10
5	Shoqëri ndërtimi	13	27	11	16	9	14	7	5	2	3
6	Mjete motorike		5	1	1					2	1

- Dhoma Kombëtare e Avokatisë për avokatët;
- Ministria e Drejtësisë për noterët dhe ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme
- Bordi i Mbikëqyrjes Publike për audituesit ligjorë dhe kontabilistët e miratuar. Etj.

⁵ Neni 22 gërma ç) mbikëqyr përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë inspektimet në vend dhe në distancë, vetëm ose në bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse;

Nr.	Subjektet	2019		2020		2021		2022		2023	
		Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë
7	Noterë	11	20	9	38	7	31	8	14	2	3
8	Lojëra Fati							1		5	1
9	Sigurim jete dhe risigurim			2		1		3			
10	Studio Ligjore		4	5	16	9	19	6			
11	Shoqëri të kursim kreditit		5		3			1	8		
12	Metale të çmuara							1			
13	Agjenci të pasurive të paluajtshme	1	8		1			2	3	2	7
14	Fonde Investimi/Pensioni/Depozitarë	3		2				2			
15	Agjenci Udhëtimi	8	1			1				1	8
16	Përmbaues Gjyqësor Privat							2	18		1

Numri i personave të trajnuar për periudhën 2019 – 2023, sipas kategorive të subjekteve.

Subjekti	2019	2020	2021	2022	2023
Banka	208	57	4	20	-
ZKV dhe agjentë të transferimit të parave	267	492	42	15	332
Shoqëri Transfertash	6	-	-	-	
IFJB	7	146	24	26	18
Shoqëri ndërmjetësimi	-	-	-	-	-
Lojëra Fati	-	-	1	2	3
Noterë/avokat	72	1,167	199	63	30
Auditues Ligjor	114	154	26	9	1
Shoqëri Sigurimi jete, broker	35	66	1	11	1
Autoritete Mbikëqyrëse dhe Institucione	20	354	5	4	-
Shoqëri tregtimi të automjeteve	10	19	-	2	-
OJF	48	-	2	1	-
Shoqëri ndërtimi	13	453	18	12	9
Shoqëri të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe të fondeve të pensionit	8	40	-	1	2
Agjentë të pasurive të paluajtshme	-	41	6	23	20
Agjenci udhëtimi	-	14	1	2	-
SHKK	-	16	1	7	-
Kontabël i miratuar	-	-	540	153	256
Përmbaues privat	-	-	-	-	5
Totali	808	3,016	870	362	677

III. Natyra e rasteve që AIF shpërndan

Gjatë analizës së rasteve të dërguara nga AIF, kur është e mundur apo ka të dhëna, identifikohet vepra penale origjinuese e dyshuar apo lidhje të mundshme kriminale të personave dhe subjekteve. Këto të dhëna mbledhen për qëllim të orientimit të punës tonë, zhvillimit të tipologjive si dhe raportimin në struktura monitoruese ndërkombëtare nëse kërkohet. Të dhënat për klasifikimin e veprës së origjinës për periudhën 2019 – 6 mujori I 2024:

Veprat e origjinës	2019	2020	2021	2022	2023	6 Muj. I 2024
Prodhim/Shitje/Trafikim të lëndëve narkotike	28	35	39	44	47	17
Trafikim i qenieve njerëzore/Shfrytëzim prostitucioni	5	4	3	6	1	0
Veprime financiare nga organizata kriminale	4	2	11	6	10	4
Veprime nga persona të dyshuar si të përfshirë në terrorizëm, FT, ekstremizëm	4	6	3	7	5	2
Mashtrim, mashtrim financiar, mashtrim kompjuterike	18	13	21	16	20	3
Falsifikim	4	2	3	5	4	1
Shpërdorim detyre/Korrupsion/Dyshim për ushtrimi të ndikimit të paligjshëm	10	12	21	7	13	6
Mos deklarim shumave dhe sendeve me vlere në kufi	3	4	0	0	0	0
Vjedhje, grabitje, kanosje	5	5	1	4	7	2
Trafikim i mjeteve motorike/Shmangie detyrime doganore/ Kontrabandë	3	3	0	2	0	0
Dyshime për evazion fiskal/Fshehje të ardhurash	14	9	4	4	7	1
Precedentë të mëparshëm kriminalë /Procedim të mëparshëm	17	11	7	20	16	9
Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit ose emigracioni i paligjshëm	-	4	0	8	3	2
Të papërcaktuara	151	158	145	95	87	48
Totali	266	268	258	224	220	95

Për një numër të konsiderueshëm rastesh vepra penale e origjinës nuk ka qenë e mundur të përcaktohet. Për këto raste analiza financiare ka konkluduar se:

- Veprimet financiare kanë patur anomali/dyshime të dukshme;
- Fondet e përdorura nuk kanë patur burime të ligjshme apo të mbështetura në dokumentacion, apo të dhëna të tjera të besueshme;
- Qëllimi ekonomiko-ligjor i kryerjes së transaksioneve ka qenë i dyshimtë;
- Kanë pasur ngjashmëri me tipologji njohura për pastrim parash si brenda vendi apo edhe ndërkombëtare,

duke u bazuar në parimin “ndiq paranë” që është një nga parimet themelore në punën e njësive të inteligjencës financiare (siç është edhe AIF), raste të cilat dërgohen për ndjekje të mëtejshme në agjencitë ligj zbatuese, në funksion edhe të gjetjes së elementëve për veprimtari kriminale.

IV. Kthim përgjigjet për kërkesat për informacion që i drejtohen AIF

Përveç funksionit të mësipërm, AIF përgjigjet për një numër të lartë kërkesash për informacion të dërguara nga dy kategori të mëdha organesh, ato të zbatimit të ligjit⁶ si ato me karakter administrativ verifikues pastërri figure (vetting) apo edhe nga organet mbikëqyrëse.

Për periudhën 2019 – 6 mujori I 2024 është kërkuar informacion nga Prokuroritë dhe/ose DPPSH si më poshtë:

Përshkrim/Viti	2019	2020	2021	2022	2023	6 – Muj. I 2024	Total
Nr. total i kërkesave nga Prokuroritë e ndryshme dhe DPPSH.	337	680	846	758	904	311	3829
Nr. total i personave (fizik dhe juridik) të përfshirë në kërkesa.	2353	4957	6050	4545	5795	2264	25964

Gjithashtu gjatë periudhës 2019-2023, AIF ka trajtuar edhe **3,525** kërkesa dhe ka kërkuar për një total prej **13,561** individë në kuadër të kërkesave të institucioneve të tjera si: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit(KPK) , Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Banka e Shqipërisë (BSH), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), Ministria e Drejtësisë (MD), Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) etj.

V. Bashkëpunimi ndërkombëtar

AIF bashkëpunon me njësi homologe jashtë vendit, në kuadër të anëtarësimit në Grupin Egmont, duke përdorur një rrjet të inkriptuar për shkëmbimin e informacionit të vlefshëm në ushtrim të funksioneve dhe detyrave që secila njësi/agjenci ka sipas legjislacionit brenda vendit përkatës .

Numri i kërkesave dhe përgjigjeve me homologët për periudhën 2019– 6 mujori I 2024:

Periudha	Shkëmbim informacioni me NjIF partnere	
	Të dërguara nga AIF	Të marra nga NjIF partnere
2019	70	120
2020	91	113
2021	82	107
2022	101	108
2023	92	85
6 – Muj. I 2024	38	48

⁶ Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme, Policinë e Shtetit, Byronë Kombëtare të Hetimit dhe autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës.

VI. Vlerësimi Kombëtar i Riskut të PP/FT

Në dhjetor të vitit 2023 Autoritetet Shqiptare konkluduan dokumentin e Vlerësimin Kombëtar të Riskut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, duke e miratuar në 27 Dhjetor 2023 nga Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP), së bashku me një plan veprimi me masa konkrete dhe të zbatueshme, në funksion të adresimit të mangësive të konstatuara.

Shqipëria ka kryer 4 vlerësime kombëtare risku prej vitit 2012, ky i fundit sipas Metodologjisë së Këshillit të Evropës, si dhe në bashkëpunim dhe me asistencën e tyre.

Vlerësimi shërben si një nga mekanizmat orientues për rreziqet madhore të identifikuara në nivel vendi dhe ndër të tjera shërben për të orientuar punën e subjekteve raportuese në përmbushjen e detyrimit për identifikimin e rreziqeve specifike për klientët, vendet apo zonat gjeografike, produktet, shërbimet, transaksionet apo kanalet e shpërndarjes. Në hartimin e këtij dokumenti në nivel vendi janë përfshirë një sërë institucionesh⁷ publike dhe private.

Ky dokument, përveçse është në dispozicion të subjekteve të ligjit (si banka, noter, etj.) është shpërndarë nga AIF për një sërë institucionesh (DPPSH, Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Posaçme për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin, Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm), autoritetet mbikëqyrëse etj.

VII. Ndryshimet ligjore

Ligji nr. 9917 datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar, prej vitit 2019 është ndryshuar 3 herë, me objektiva si më poshtë:

- Në vitin 2019 me synim përmbushjen e disa rekomandimeve sipas raportit të Moneyval (2018);
- Në vitin 2021, me synim përputhjen me Direktivat e BE në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Në vitin 2023, me synim mundësimin e lidhjes së marrëveshjeve nga AIF edhe me organe të tjera përtej atyre homologe jashtë vendit, lehtësimin e disa pengesave ligjore (në përputhje me standardet e FATF dhe të BE) lidhur me vendosjen e marrëdhënieve të biznesit me klientët duke përdorur platforma/programe digjitale, rritja e trajtimit financiar për punonjësit e AIF etj.

Në vitet e fundit, ndryshimet ligjore në nivel vendi, janë ndikuar edhe nga kërkesat e ICRG/FATF, ndryshimet e standardeve përkatëse apo përafrimi me legjislacionin e fushës së BE.

⁷ Agjencia e Inteligjencës Financiare, Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruar dhe Konfiskuara, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Instituti i Statistikave Shtetërore (INSTAT), Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, Qendra Kombëtare e Biznesit, si dhe subjektet e ligjit rast pas rasti.

Konkretisht një bashkëpunimi dhe koordinimi midis institucioneve u bë i mundur hartimi dhe miratimi si më poshtë:

4 Ligje të reja:

1. Ligji për regjistrimin e pronarëve përfitues (Viti 2020);
2. Ligji për regjistrin e centralizuar të llogarive bankare (Viti 2020);
3. Ligji për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme (Viti 2022);
4. Ligji për regjistrimin e OJF-ve. (Viti 2021);

4 Ndryshime ligjore

1. Për disa ndryshime në ligji për regjistrin tregtar; (Viti 2019 dhe 2022);
2. Për disa ndryshime në ligjin për Noterinë; (Viti 2021);

Përveç ndryshimeve ligjore, u ngritën edhe regjistrat/sisteme si më poshtë:

2 Regjistra të rinj

1. Regjistri elektronik i pronarëve përfitues;
2. Regjistri i centralizuar i llogarive bankare.

2 Sisteme elektronike

1. Sistemi i letër porosive në administrim nga Ministria e Drejtësisë;
2. Sistemi PRESTO në funksion të institucioneve të Prokurorisë.

VIII. Procesi i monitorimit të Shqipërisë nga institucionet ndërkombëtare (FATF dhe MONEYVAL)

Në plenaren e Taks Forcës të Veprimit Financiar (FATF⁸) të datës 27 tetor 2023 u vendos dalja e Shqipërisë nga “*lista gri*” e pastrimit të parave, ku u vlerësuan reformat e ndërmarra nga Shqipëria gjatë periudhës në monitorim, lidhur me përmirësimin e sistemit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Vendimi i FATF për daljen e Shqipërisë nga “*lista gri*” u bazua në raportin e vlerësimit të Grupit të Përbashkët (Joint Group – JG) të ICRG/FATF. Ky raport nuk është publik, por është ndarë me institucionet përkatëse brenda vendit.

Në këtë raport, përveç vlerësimeve pozitive për Shqipërinë në përmbushjen e planit të veprimit, JG ka propozuar edhe disa rekomandime, të cilat pavarësisht se nuk janë teknikisht të detyrueshme, duhet të mbahen në vëmendje nga Shqipëria në përmirësimin e mëtejshëm të sistemit parandalues të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë, si më poshtë vijon:

- Nëse Shqipëria do të hartojë në të ardhmen një program mbi amnistinë fiskale, JG inkurajon Shqipërinë të punojë me partnerët ndërkombëtarë për të siguruar që çdo program i tillë të jetë në përputhje me parimet dhe praktikat më të mira të FATF-së për programet e amnistisë fiskale (VTC programme).
- JG inkurajon Shqipërinë të arrijë progres të mëtejshëm në ndjekjen e më shumë hetimeve penale dhe ngritjen e akuzave për veprën penale të pastrimit të produkteve të

⁸ <https://www.fatf-gafi.org/en/the-fatf/what-we-do.html>

veprës penale (pastrimin e parave) në lidhje me rreziqet e larta të identifikuar për pastrim parash si korrupsioni, krimi i organizuar dhe trafikimi i narkotikëve, me fokus të veçantë rastet kur vepra penale mëmë të jetë kryer në juridiksion të huaj.

- JG inkurajon Shqipërinë të arrijë progres të mëtejshëm nëpërmjet një koordinimi më të gjerë ndërinstitucional për të vlerësuar kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe për të zhvilluar politika dhe strategji për të adresuar këto kërcënime. SPAK duhet të përfshihet plotësisht në këto përpjekje.
- JG i kërkon Shqipërisë që të ngrejë dhe të zbatojë një sistem të menaxhimit të rasteve me qëllim zëvendësimin e sistemit aktual të përdorur nga prokurorët për të menaxhuar dhe ndjekur ecurinë e rasteve.
- Shqipëria duhet të investojë në burime, njerëzore dhe teknologjike, në luftën kundër kërcënimeve të reja në fushën e pastrimit të parave (p.sh., krimi kibernetik, asetet virtuale, etj.).

Shqipëria është në proces “monitorimi të zgjeruar”⁹ prej vitit 2018 nga Komiteti MONEYVAL¹⁰, pjesë e KiE (Këshillit të Evropës), mbi vlerësimin e masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Vlerësimi i Moneyval përqendrohet në raportimet e shteteve në lidhje me përputhshmërinë teknike të kuadrit ligjor të vendit me 40 Rekomandimet e FATF¹¹ dhe efektivitetin e masave të marra në kuadër të sistemit parandalues të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Prej vitit 2018 Shqipëria ka punuar në mënyrë intensive për arritjen e përputhshmërisë teknike dhe ka arritur një progres thelbësor në përmbushjen e 40 rekomandimeve. Kjo është reflektuar nëpërmjet progres raporteve të dërguara nga Shqipëria gjatë fazës së monitorit të zgjeruar (Progres raporti i 1-rë, 2-të, 3-të dhe 4-rt) të cilat janë miratuar përkatësisht në dhjetor 2019, prill 2021, maj 2022 dhe maj 2023.

Deri aktualisht përputhshmëria e kuadrit ligjor lidhur me sistemin parandalues të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me 40 rekomandimet e FATF, sipas vlerësimit të Moneyval, paraqitet si më poshtë:

- “të përputhura” (C) - 6 rekomandime;
- “gjerësisht të përputhura” (LC)- 31 rekomandime¹²;
- “pjesërisht të përputhura” (PC) - 2 rekomandime¹³;

⁹ “Monitorimi i zgjeruar” përfshin një proces më intensiv monitorimi nga Komiteti MONEYVAL.

¹⁰ <https://www.coe.int/en/web/moneyval> The Committee of Experts on the Evaluation of Anti-Money Laundering Measures and the Financing of Terrorism - MONEYVAL is a permanent monitoring body of the Council of Europe entrusted with the task of assessing compliance with the principal international standards to counter money laundering and the financing of terrorism and the effectiveness of their implementation, as well as with the task of making recommendations to national authorities in respect of necessary improvements to their systems. Through a dynamic process of mutual evaluations, peer review and regular follow-up of its reports, MONEYVAL aims to improve the capacities of national authorities to fight money laundering and the financing of terrorism more effectively.

¹¹ <https://www.fatf-gafi.org/en/the-fatf/what-we-do.html> The Financial Action Task Force (FATF) leads global action to tackle money laundering, terrorist and proliferation financing. The FATF researches how money is laundered and terrorism is funded, promotes global standards to mitigate the risks, and assesses whether countries are taking effective action.

¹² Vlerësimi “i përputhur” dhe “gjerësisht të përputhur” nënkupton që kuadri ligjor shqiptar parashikon mekanizmat dhe garancitë ligjore në përputhje me rekomandimin pjesë të vlerësimit.

¹³ Rekomandimi 7 “Masat shtrënguese ndërkombëtare për financimin e armëve të shkatërrimit në masë” dhe Rekomandimi 15 “Teknologjitë e reja”

-
- “të pa zbatueshme” (N/A) - 1 rekomandim¹⁴;
 - Shqipëria nuk ka asnjë rekomandim “të pa-përputhur”.

Lidhur me dy rekomandimet që janë ende “pjesërisht të përputhura” (PC):

- Rekomandimi 7 “Masat shtrënguese ndërkombëtare për financimin e armëve të shkatërrimit në masë”
Me miratimin në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë të datës 14 Dhjetor 2023 të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 72/2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në RSH”, e cili është hartuar edhe me asistencën e ekspertit të Këshillit të Evropës, vlerësohet se ky rekomandim plotëson gjerësisht standartet e kërkesave të rekomandimit. Për këtë rekomandim nuk kemi ende vlerësim nga ekspertët e Komitetit MONEYVAL.
- Rekomandimi 15 “Teknologjitë e reja- ofruesit e mjeteve virtuale”
Në lidhje me këtë rekomandim synohet një përmbushje sa më e shpejtë dhe ka filluar puna në koordinim të plotë me institucionet përgjegjëse, si dhe me mbështetje përmes ekspertizës të ofruar në kuadër të “Projektit kundër krimit ekonomik në Shqipëri” (AEC-AL), program i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian.

Lidhur me rekomandimin Nr. 17

- Rekomandimi 17 “Mbështetja në palët e treta”, vlerësuar i pa aplikueshëm (N/A) në vlerësimin e vitit 2018 nga Komiteti MONEYVAL për shkak se Shqipëria nuk kishte të parashikuar ligjërisht në atë kohë këtë instrument.
Në Qershor 2019 dhe Dhjetor 2021 Shqipëria përfshiu në ligjin 9917/20018 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” dispozitat përkatëse për mbështetjen e institucioneve financiare në palë të treta gjatë procesit të vigjilencës së duhur të klientit (përkatësisht nenet 5 dhe 6/1) në përputhje me rekomandimin 17 të FATF.
Në Maj 2024 Shqipëria me mbështetjen financiare të KiE në Shqipëri realizoi një analizë të kuadrit ligjor shqiptar në lidhje me përputhshmërinë me Rekomandimin 17, ku nga vlerësimi i realizuar nga ekspertët ndërkombëtarë rezultoi përputhshmëri e lartë e legjislacionit shqiptar me Rekomandimin 17.

IX. Propozime për ndryshime ligjore

Në lidhje me propozimet për ndryshimet ligjore në këtë fazë na lejoni t’Ju informojmë se bazuar në vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare FATF dhe MONEYVAL aktualisht kuadri ligjor i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është në masën

¹⁴ Rekomandimi 17 “Mbështetja në palët e treta”

95% i përafuar me rekomandimet e FATF dhe përputhshmëri të plotë me Direktivat AML/CFT të BE¹⁵.

Në vitin 2025- 2026 Shqipëria do ti nënshtrohet vlerësimit të raundit të 6-shtë nga Komiteti MONEYVAL që nënkupton vlerësimin tërësor të kuadrit ligjor shqiptar për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si në aspektin e teknikalitetit edhe në aspektin e efektivitetit. Kjo do të thotë që në saj të vlerësimit që do të miratohet nga Komiteti MONEYVAL në plenaren e Dhjetor 2026, Shqipëria do të njihet me nevojën për përputhshmëri të mëtëjshme të kuadrit ligjor me rekomandimet e FATF (nëse do të ketë).

Ndërkohë për ti paraprirë këtij procesi me vendimin nr. 1 datë 27.12.2023 të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, është ngritur Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës i cili është i ngarkuar edhe me detyrën për përgatitjen për vlerësimin e raundit të 6-shtë nga Komiteti MONEYVAL. Agjencia e Inteligjencës Financiare ka rolin e institucionit koordinues në këtë grup dhe ndërkohë ka filluar puna për plotësimin paraprak të pyetësorëve dhe realizimin e ushtrimeve simuluese me institucionet përgjegjëse. Realizimi i ushtrimeve simuluese dhe vlerësimi i plotësimit paraprak të pyetësorëve do të realizohet nga ekspertë ndërkombëtarë falë mbështetjes të partnerëve tanë si Ambasada e Mbretërisë të Bashkuar në Tiranë, Ambasada Amerikane, GIZ dhe KiE zyra në Tiranë. Në këtë kuadër vlerësojmë që ekspertët ndërkombëtarë gjatë këtij procesi mund të nxjerrin në pah aspekte të kuadrit ligjor Shqiptar që mund të kenë nevojë për përmirësim të mëtëjshëm me qëllim mirë përgatitjen për vlerësimin zyrtar nga Komiteti MONEYVAL në 2025-2026.

Ndërkohë në nivelin e përputhshmërisë me direktivat e BE në fushën AML/CFT zhvillime dinamike po ndodhin së fundmi. Parlamenti Evropian ka miratuar në Prill 2024 një paketë të plotë ligjore në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Kjo paketë ligjore kërkon miratimin final nga Këshilli Evropian dhe publikimin më tej në fletoren zyrtare të BE. Paketa e re ligjore do të sjelli zhvillime të shumta në këtë fushë dhe rrjedhimisht kjo do të kërkojë edhe përputhshmëri ligjore të kuadrit ligjor Shqiptar, por ky proces parashikohet të fillojë gjatë viteve 2026-2027.

X. Puna në proces për hartimin e strategjisë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Në mbledhjen e datës 27.12.2023 KBLKPP, ndër të tjera, vendosi edhe Hartimin i “*Strategjisë Kombëtare për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2024-2030*”.

Ky dokument është tanimë në fazë të avancuar dhe pritët që brenda muajit Korrik 2024 te dërgohet diskutimi dhe miratim në KBLKPP. Gjatë hartimit të kësaj strategjie, Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës është asistuar nga ekspert të GIZ si dhe Këshillit të Evropës.

¹⁵ Direktiva 849/2015 ndryshuar me direktivën 843/2018 “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit dhe ndryshimin e Direktivave 2009/138/KE dhe 2013/36/BE.

Draft Strategjia, në funksion të përmirësimit dhe modernizimit të regjimit kundër PP/FT, ka identifikuar prioritetet si vijon:

- 1) Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe rregullator;
- 2) Rritja e mëtejshme e kapaciteteve institucionale, koordinimit ndër-institucional si dhe rritja e ndërgjegjësimit publik si dhe përfshirja e aktorëve përgjegjës të sektorit privat;
- 3) Rritja e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare dhe shtimi i mbikëqyrjes;
- 4) Përdorimi dhe shfrytëzimi i inovacioneve teknologjike duke zvogëluar rreziqet.
- 5) Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Për arritjen e objektivave të sipërcituar, do të miratohet një plan veprimi, për periudhën 2024-2030.

“Strategjia kombëtare për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2024-2030” parashikohet të miratohet nga Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave në fund të muajit Korrik 2024, të cilën do jua dërgojmë sapo të miratohet.

XI. Përfaqësuesit e AIF në komision

Përfaqësuesit e AIF në Grupin e Ekspertëve që do të ngrihet për këtë qëllim pranë komisionit do të jenë:

- **Z. Agim Muslia** - Drejtor i Drejtorisë së Përputhshmërisë dhe Teknologjisë së Informacionit (amuslia@fint.gov.al);
- **Z. Artan Shiqerukaj**, Drejtor i Drejtorisë të Analizës (ashiqerukaj@fint.gov.al).

Duke ju falënderuar, mbetemi në dispozicion për çdo informacion të mëtejshëm në funksion të punës së Komisionit.

Me konsideratë të lartë,

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Ervin Koçi

